



PËRJETO DUKAGJININ NË 100 MËNYRA

KALENDAR I
KULTURËS DHE
REKREACIONIT
2019

CH
WB
Cultural
Heritage without Borders
KOSOVO

Ky kalendar ofron një listë prej 100 aktiviteteve në fushën e kulturës dhe rekreacionit që çdokush mund ti përjetoj në Dukagjin. Komunitetet që mbulojnë këtë rajon (Deçani, Gjakova, Istogu, Juniku, Klina dhe Peja) janë të njohura për peizazhin e pasur dhe arkitekturën unike si rezultat i rrethanave të ndryshme historike.

Historia e larmishme e këtij rajoni daton që nga periudhat e hershme. Në këtë territor janë zbuluar tumat ilire, ndërkohë që periudha e vonë romake është e pranishme me mbetjet arkeologjike të një vendbanimi Romak të gjetur në Dresnik, në Komunën e Klinës. Përveç kësaj, zona ka dy (2) lokalitete nga lista e trashëgimisë botërore të UNESCO-s, Patriarkana e Pejës dhe Manastiri i Deçanit që datojnë nga mesjeta. Një tip karakteristik i arkitekturës që gjendet në zonë është Kulla, e cila në të kaluarën ka shërbyer si ndërtesë e fortifikuar banimi, ndërsa sot shumë prej këtyre strukturave janë përshtatur për të ofruar shërbime të akomodimit, ushqimit tradicional dhe një eksperiencë unike udhëtimi për turistë. Trashëgimia osmane bëhet e dukshme me

praninë e çarshive në qendrat kryesore ekonomike Pejë dhe Gjakovë, të rrethuara nga lagjet tipike zejtare dhe rrugicat e ngushta me kalldërm.

Natyra e pasur ofron përvoja të shumta rekreative turistike. Ngjitja në majën më të lartë në Kosovë, Gjeravica (Junik), 2656m, ecja nëpër kanionin e lumit Drini i Bardhë dhe eksplorimi i shpellave të shumta në Istog ose aktivitetet më ekstreme, si ziplining dhe paragliding ose skijimi i lirë “freeride” janë ndër mundësitë që ofrohen nga shumë operatorë turistikë në këtë rajon. Entuziastët e sporteve të ujit mund të shijojnë bukuritë e ujëvarës së Mirushës në Klinë, liqenin e Gjeravicës në Junik, liqenin e Radoniqit në Gjakovë, burimet termale në Istog dhe mund të konkurrojnë në gara të zhytjes nga Ura e Fshajte në Gjakovë. Ky kalendar është hartuar në bashkëpunim me gjashtë (6) komunitat e rajonit perëndimor. Datat e aktiviteteve mund të ndryshojnë për shkak të motit dhe rrethanave teknike. Për më shumë informata për secilën ngjarje mund të kërkoni online nga ueb faqet e dedikuara apo faqet e mediave sociale të ofruesit të shërbimit.

JANAR SHKURT MARS

09/100
ngjarje kulturore

09/100

JANAR

JANAR 2019 ●

Kampionati i Skitarisë -
Kupa Memoriale “Hajrush
Demaj”

—

Pejë, Bogë e Rugovës,
Qendra e Skijimit

25 JANAR 2019 ●

Turniri memorial në futboll të
vogël me rastin e përvjetorit
të dëshmoreve të Kombit “
Zahir Pajaziti, Edmond Hox-
ha dhe Hakif Zejnullahu”

—

Junik, Salla e Sporteve
“Ereniku”

SHKURT

17 SHKURT 2019

17 Shkurti Koncerti Festiv,
Dita e Pavarësisë së Kosovës

—

Gjakovë, Qendra e Qytetit

17 SHKURT 2019

Ngjitja për Pavarësinë

—

Junik, Gjeravicë

17 SHKURT 2019

Turniri i Pavarësisë
në ping-pong

—

Junik, Gjimnazi “Kuvendi i
Junikut”

➤ Me rastin e Ditës së Pavarësisë së Kosovës, organizohet ngjitja në Majen më të lartë të Kosovës “Gjeravica” 2656m në Junik.

Ecjet në bjeshkë drejt pushtimit të kësaj Maje zhvillohen me nisje prej Junikut. Shtegu i ecjes kalon në disa zona të karakterit të veçantë, me shtigje të lashta bjeshke, liqene akullnajore,

kulloso alpine, si dhe rrëqe të pastra. Vet pamja nga Gjeravica është tregues i pozitës së jashtëzakonshme të kësaj maje, nga kjo pikë mund të shihen pothuajse të gjitha vargmalet shqiptare, që nga Malësia e Madhe, Zhaboret e Veriut, Radohima, Bjeshkët Perëndimore, etj.



MARS

MARS 2019

Turniri në Boks
“Epopeja e Dukagjinit”

—

Pejë, Palestra Sportive
“Karagaq”

23-24 MARS 2019

Epopeja e Dukagjinit

—

Deçan, Gllogjan

9 MARS 2019

Garat e Skijimit
“Kupa e Gjeravicës” 2019

—

Deçan, Bjeshka e Belegut

7-8 MARS 2019

Turneu në hendboll
për Ditën e Gruas

—

Gjakovë, Pallati i Sportit

PRILL MAJ QERSHOR

51/100
ngjarje kulturore

51/100

PRILL

PRILL 2019

Turniri Memorial në Karate
“Haki Iberdemaj”

—

Pejë, Palestra e Sporteve
Karagaq

PRILL 2019

Turniri i Xhudos
“Judo For Peace”

—

Pejë, Federata e Xhudos

23-24 PRILL 2019

International Dog Show/
CACIB

—

Pejë, Parku i Karagaqit

PRILL 2019

Ditët e Vëllazërisë

—

Istog

> **Klubi i Xhudos “Ippon”**, F.X.H.K dhe MKRS në bashkëpunim me Komunën e Pejës organizon turnirin e përvitshëm në xhudo “Turniri i Paqes” në Pejë. Turniri organizohet me qëllim që të promovojë Paqen në të gjitha format e saj në të gjitha anët e botës. Turniri ka karakter ndërkombëtar me pjesëmarrje nga ekipet nga Kosova dhe shtetet e tjera.



> CACIB Peja është ekspozitë ndërkombëtare Kinologjike që mbahet në qytetin e Pejës, ku bëhet promovimi i qenëve të trajnuar dhe të edukuar. Në këtë aktivitet marrin pjesë organizata të ndryshme të qejve nga Kosova dhe nga vende të ndryshme të Evropës. Organizimi është i përvitshëm, si bashkëpunim midis CACIB Peja dhe Federatës Kinologjike të Kosovës.



PRILL

11 PRILL 2019 🇷🇸

14 KORRIK 2019

11 GUSHT 2019

View point Podguri &
Via Ferrata Shpellat Binjake

—
Istog, Shpellat Binjake,
Bajshë

> Ecjet Bjeshkatore në Komunën e Istogut janë pasuruar me Pikën e re Vrojtuese, View Point – Podguri, e ndërtuar te Burimi i Istogut. Shtegu deri te kjo pikë vrojtuese është prej 986m dhe është i siguruar sipas standardeve. E njëjta ofertë zgjerohet edhe për ecjen përgjatë Via Ferrata – Shpellat Binjake me gjatësi të shtegut prej 70m e cila realizohet me guidë malore dhe me përdorimin e pajisjeve për alpinizëm të cilat sigurohen nga menaxhuesit e shërbimit.

3-10 PRILL 2019 🇮🇹

Java Rome

—
Gjakovë



> Java Rome shënohet për nder të Ditës Ndërkombëtare të Romëve – 8 prilli. Qëllimi i javës rome është ti sensibilizoj qytetarët dhe institucionet mbi kulturën rome. Përgjatë kësaj jave organizohen aktivitete të sferave të ndryshme si ligjerata, tryeza të rrumbullakta, vizita në institucione, debate mediale, ekspozita në vende të hapura dhe shumë aktivitete të tjera.



MAJ

MAJ 2019

Takimet Letrare
“Azem Shkreli”

—

Pejë, Biblioteka “Azem Shkreli”

MAJ 2019

Garat në Motokros
“Motocross Team Peja”

—

Pejë, Kodrat në Tabje

MAJ 2019

Sabor Boshnjaka

—

Pejë, Vitomiricë

MAJ 2019

Festivali “Eshkë e Ndezur në
Shkëlzen”

—

Deçan, Qendra e Qytetit,
Pallati i Kulturës

> Garat ndërkombëtare të motoçiklizmit “Motocross Team Peja” organizohen për cdo vjet në Kodrat Tabje të Pejës me pjesëmarrës dhe dashamirës të shumtë të këtij sporti ekstrem nga vendi e nga bota. Garat zhvillohen jashtë shtegut rrugor, në terrenin malor dhe peisazhin e bukur të Kodrave Tabje.



MAJ

20 MAJ 2019 🟢

Turniri Tradicional në Shah
“Zeqë Hasaj”

—

Deçan, Pallati i Kulturës

5 MAJ, 9 QERSHOR 2019 🇷🇸

Paragliding

—

Pejë, Shymek, Bjeshkët e
Istogut

6-10 MAJ 2019 📖

Mitingu i Poezisë

—

Gjakovë, Biblioteka “Ibrahim
Rugova”

5 MAJ 2019 🟢

Turniri memorial për
dëshmorin “Luan Haradinaj”

—

Junik, Salla e Sporteve
“Ereniku”

20 MAJ DHE 24 TETOR 2019 🇹🇷

Fëmijët në Skenë

—

Gjakovë, Pallati i Kulturës

> Lëshime të lira me parashutë (paragliding) organizohen rregullisht në Bjeshkët e Istogut nga organizata profesionale në këtë fushë. Kosova ofron natyrën me kushtet ideale për të zhvilluar këtë sport ekstrem. Bjeshkët e Istogut mirëpresin dashamirës të këtij sporti nga e tërë bota për të shijuar natyrën dhe mikëpritjen e vendit.



QERSHOR

QERSHOR 2019

Reel Rock Pejë

—

Pejë, Kinema Jusuf Gërvalla

QERSHOR 2019

Street Ball

—

Pejë, Qendra qytetit - Sheshi Kryesor

QERSHOR 2019

Pejë Interantional Guitar Festival/ Festivali i Kitarës

—

Pejë, Rr. “Fehmi Agani”

QERSHOR, SHTATOR 2019

Street Art Peja Edicioni III

—

Pejë, Shymek, Bjeshkët e Istogut

16 QERSHOR 2019

Dita e Çlirimit të qytetit të Pejës

—

Pejë, Qendra Kulturore

QERSHOR 2019

Festivali i Monodrames “Mono Akt”

—

Pejë, Teatri i Pejës “Istref Begolli”

QERSHOR 2019

Panairi i Librit në Pejë

—

Pejë, Biblioteka “Azem Shkreli”

QERSHOR

QERSHOR, SHTATOR 2019

Via Ferrata dhe Zip Line

Pejë, Kilometri i 5-të i Grykës së Rugovës

QERSHOR 2019

Shpella Gryka e Madhe

Pejë, Kilometri i 7-8-të i Grykës së Rugovës

> Gjatë gjithë sezonit veror në Komunën e Pejës, saktësisht në Kilometrën e 5-të të Grykës së Rugovës, janë të hapur për vizitorë atraksionet turistike që ofron Via Ferrata (ecje/ngjitje në një nga muret (kërrshat) e Grykës së Rugovës), ku OJQ dhe kompani vendore menaxhojnë me ofertën dhe lëshojnë me qera pajisjet e nevojshme për këtë aktivitet që zgjat rreth 2 orë. Një opcion tjetër për vizitorë të interesuar është Zipline, si ikonë e eko-turizmit në kohërat moderne. Zipline është një kablo e pezulluar në pjerrtësinë e Grykës së Rugovës, që shfrytëzon forcën gravitacionale për tu lëshuar përmes vijës së përcaktuar dhe për të shijuar peisazhin malor. Turistët përforcohen në kablo të siguruar me pajisje që ofrohen nga menaxhuesit e këtyre shërbimeve.



QERSHOR

16 QERSHOR 2019

Dita e Çlirimit të Deçanit

—

Deçan, Qendra e Qytetit

9 QERSHOR 2019

Pushtimi i Majes Gjeravica

—

Deçan, Gjeravicë

1 QERSHOR 2019

Festivali “Fëmijët Këndojnë”

—

Istog, Shtëpia e Kulturës
“Adem Jashari”

QERSHOR, SHTATOR 2019

Shpella “Bukuroshja e Fjetur”

—

Istog, afër burimit të Drinit të
Bardhë

20 QERSHOR 2019

Dita e Çlirimit të Istogut

—

Istog, Qendra e Qytetit

6- 8 QERSHOR 2019

Festivali “I Këndojmë Lirisë”

—

Klinë, Çabiç dhe Klinë

> Festivali tradicional i folklorit “I Këndojmë Lirisë” mbahet në Klinë, dhe shërben si vendtubim dhe vendtakim i artdashësve të folklorit burimor shqiptar të të gjitha trojeve etnike. Festivali organizohet për nder të lirisë, pavarësisë dhe trimërisë të luftëtarëve dhe përkon me ditëlindjen e Komandantit të rënë Mujë Krasniqi. Festivali nis në Qabiq, vendlindjen e Mujë Krasniqit, nga Kulla-Muze. Gjatë 3 ditëve organizohen koncerte me këngë e valle dhe aktivitete të tjera kulturore dhe sportive.



QERSHOR

18 QERSHOR 2019

Dita e Çlirimit të Klinës

—

Klinë, Sheshi “Mujë Krasniqi”

21-25 QERSHOR 2019

Festivali “Pianisti i ri”

—

Gjakovë

12, 14 QERSHOR 2019

Dita e Çlirimit të Gjakovës

—

Gjakovë, Pallati i Kulturës,
Sheshi i Qytetit

QERSHOR-SHTATOR 2019

Ngjarjet - Parku Kulturor “Ali
Podrimja”

—

Gjakovë

21 QERSHOR 2019

Dita Ndërkombëtare e
Muzikës

—

Gjakovë, Shkolla e Muzikës
“Prenk Jakova”

QERSHOR 2019

Çarshia Fest

—

Çarshija e Gjakovës

> Çarshia Fest është festival që organizohet në Çarshinë e Gjakovës që njihet si çarshia më e madhe në Evropën Juglindore. Ideja e këtij organizimi është që përmes festës të promovohet dhe të mbrohet Çarshia e Madhe që është rikthyer nga shkatërrimi në një zonë të frekuentuar dhe pikë destinimi për Gjakovën. Gjatë tërë ditës përgjatë Çarshisë, në 4 skena të ndryshme ka performanca të shumta muzikore nga artistë dhe lokalet ofrojnë shërbimet dhe mikëpritjen gjakovare.



QERSHOR

QERSHOR 2019

Panairi i Artizanateve

—

Gjakovë

20-21 QERSHOR 2019

Ditët e Gjeravicës

—

Junik

13 QERSHOR 2019

Dita e Çlirimit të Junikut

—

Junik, Qender, sheshi “Edmond Hoxha”

QERSHOR 2019

Downhill Gjeravica

—

Junik, Gjeravicë

1 QERSHOR 2019

Festa Ndërkombëtare e
Fëmijëve dhe e Abetares

—

Junik, Shkolla Fillore

15-16 QERSHOR 2019

Kampi Gjeravica

—

Junik, Bjeshkët e Junikut

KORRIK GUSHT SHTATOR

84/100
ngjarje kulturore

84/100

KORRIK

KORRIK 2019

Ditët e Diasporës

—

Pejë, Rr. "William Walker"

KORRIK 2019

Kolonia e Artit

—

Istog, Galeria e Artit

KORRIK 2019

Lojërat Tradicionale të

Rugovës

—

Pejë, Kuqishtë

KORRIK 2019

Ditët e Diasporës

—

Deçan, Qendra e Qytetit,
Pallati i Kulturës

7-13 KORRIK 2019

Festivali i Artit Pamor në
Kulla

—

Deçan, Fshatrat e Komunës
së Deçanit

KORRIK 2019

Camping Fest

—

Klina, Dresnik

> Lojërat tradicionale të Rugovës janë lojëra popullore, karakteristike etnokulturore e trevës së Rugovës dhe prezantojnë shumëllojshmërinë e traditës së zakoneve dhe dokeve të kësaj treve malore. Lojërat zhvillohen në këto disiplina: ngjitja në shilor, rrëzimi i duarve, mundja, hedhja e llastarit, gurapeshi, tërheqja e litarit e shumë të tjera. Garat shoqërohen me muzikë tradicionale dhe valle popullore.



KORRIK

15-21 KORRIK 2019

Anibar

—

Pejë, Kino “Jusuf Gërvalla”

KORRIK 2019

Çmimi Mbarëkombëtar Poetik “Dr. Ibrahim Rugova”

—

Istog

KORRIK 2019

Festivali Tradicional “Sofra”

—

Gjakovë, Lama e Drithit

KORRIK 2019

Festivali “N’Odën e Malësisë së Gjakovës”

—

Gjakovë, Sheshi -Gjakovë

> Festivali i Filmit të Animuar Anibar, i vetmi i këtij lloji në Kosovë është i hapur për animatorë, artistë dhe audiencë nga e gjithë bota. Pjesëmarrësit kanë mundësinë të ndjekin shfaqjen e filmave të animuar apo të bëhen pjesë e aktiviteteve të tjera si punëtori, prezantime e masterklasa. Aktivitetet e Anibarit që zhvillohen gjatë 1 jave, mbahen në 4 kinema të qytetit të Pejës, 2 kinema në ambient të hapur dhe 2 kinema të mbyllura (kinemaja “Jusuf Gërvalla” dhe Teatri “Istref Begolli”).



GUSHT

GUSHT 2019

Mitingu i Motoristëve “Steel-wings” Kosova

—

Pejë, Rr. “William Walker”

1 GUSHT 2019

Ndeshja Reviale ne mes te veteranve nga Diaspora dhe Peja

—

Pejë, Stadiumi i Qytetit
“Shahin Haxhiislami”

GUSHT 2019

Open Fun Football

—

Pejë, Vitomiricë, Stadiumi i Futbollit

GUSHT 2019

Ditët e Diaspores Boshnjake/Dani Diaspore

—

Pejë, Vitomiricë, Shtëpia e Kulturës në Vitomiricë, Bokud Djerdan

GUSHT 2019

Java e Zejtarisë

—

Pejë

GUSHT 2019

Rituali i Qethjes së Deleve

—

Deçan, Bjeshkët e Deçanit

GUSHT 2019

Dita e Bashkëatdhetarëve
“Mirësevini Bashkëatdhetarë”

—

Istog, Banjë

18 GUSHT 2019

Ecje me Bicikleta, Gurrat e Bardha - Bajshë

—

Istog, Bajshë, Gurrat e Bardha, Bajshë

22-30 GUSHT 2019

Festivali “Esmā”

—

Gjakovë, Pallati i Kulturës

18 GUSHT 2019

Gara Auto Sllallom

—

Gjakovë

6-13 GUSHT 2019

Ditët e Diasporës

—

Junik, Moronica, Amfiteater

GUSHT

GUSHT 2019

Festivali “Të Qethat”

Istog, Bjeshkët e Istogut -
Lugu i Butë



> Kërcimet nga Ura e Fshajtë janë gara të zhytjes së lartë që organizohen në Gjakovë nga një lartësi prej 22m, në Urën që lidh Gjakovën me Prizrenin. Garat organizohen tradicionalisht në këtë qytet që nga fundi i viteve të 50-ta. Në këtë ngjarje marrin pjesë garues të shumtë me nam nga e tërë bota dhe ka prezantim të gjerë medial. Garat zhvillohen në kërcim me këmbë dhe kërcim dallëndyshe.

GUSHT 2019

Garat e Urës së Fshajtë

Gjakovë, Ura e Fshajtë

> Riti i Qethjes së Deleve është traditë e lashtë në rajonin e Dukagjinit. Komuna e Istogut e organizon cdo vjet këtë ngjarje në Bjeshkët e Istogut te Lugu i Bardhë. Vizitorët e ndryshëm gjatë ditës kanë mundësinë të jenë dëshmitarë të qethjes së deleve në mënyra tradicionale nga blegtorët e Komunës së Istogut, si dhe të shijojnë natyrën malore dhe ushqimet tradicionale nën tingullin e këngëve dhe valleve popullore.



SHTATOR

SHTATOR 2019

Panairi "Ditët e Mjaltit"

—

Pejë, Qendra e Qytetit -
Sheshi i Dëshmorëve

SHTATOR 2019

FASK - dhe Automoto -
"Peja VISARI"

—

Pejë, Rruga e Kullës

29-30 SHTATOR 2019

Ecje Bjeshkatore - Maja e
Hajlës

—

Pejë, Hajlë

21 SHTATOR 2019

Festivali Tradicional
i Fëmijeve "Ardhmëria"

—

Deçan, Pallati i Kulturës

SHTATOR 2019

Dita e Mollës

—

Istog, Kovragë

1 SHTATOR 2019

Ecje me Bicikleta dhe Kampi
Kodra e Dynës

—

Istog, Vrellë, Kodra e Dynës

6 SHTATOR 2019

Manifestimi Letrar "Ora e
Tahir Deskut"

—

Klinë, Shtëpia e Kulturës

27 SHTATOR 2019

Përmbyllja e Kulturave
Verore

—

Gjakovë, Pallati i Kulturës

SHTATOR 2019

Komedia Fest

—

Gjakovë, Pallati i Kulturës

7-9 SHTATOR 2019

Gara Malore Auto Sllallom

—

Gjakovë

TETOR NËNTOR DHJETOR

100/100
ngjarje kulturore

100 / 100

TETOR

TETOR 2019 🏠

Shënimi i Ditëve Kulturore
“Jusuf Gërvalla”

—

Pejë, Qendra Kulturore

8-9 TETOR 2019 🚶

Ecje Bjeshkatore - Liqenat,
Rugovë

—

Pejë, Liqenat, Rugovë

29 TETOR 2019 🚶

Ecje Bjeshkatore - Shtupeq i
Vogël, Maja e Hasanit

—

Pejë, Maja e Hasanit

TETOR 2019 🏠

Dita e Gështenjës

—

Deçan, Deçan-Eko Tregu

13-15 TETOR 2019 🚶

Gurra e Folklorit Shqiptar

—

Istog, Shtëpia e Kulturës
“Adem Jashari”

15 TETOR 2019 🌊

Çiklizëm dhe Ecje
Bjeshkatore Mokna

—

Istog, Malet Mokna



> Dita e Gështenjës është aktivitet tradicional që shënohet nga Komuna e Decanit, përmes panairit ku ekspozohet ky produkt për të cilin edhe është i njohur rajoni. Qëllimi i këtij organizimi është të promovojë gështenjën me produktet dhe nënproduktet e saj në mënyrë që të rritet numri i kultivuesve të saj. Ky festim shoqërohet me koncert e valle popullore dhe ushqime tradicionale.

TETOR

TETOR 2019

Gjakova Highland
Marathon

—

Gjakovë

TETOR 2019

Dita e Gështenjës

—

Junik, Oborri i Gjimnazit
“Kuvendi i Junikut”

NËNTOR

23-24 NËNTOR 2019

Ecje në Shtegun “Ibrahim Rugova”, Maja e Dynës
—
Istog, Vrellë, Kodra e Dynës

28 NËNTOR 2019

Manifestimi Tradicional
“Art Klina”
—
Klinë, Shtëpia e Kulturës

NËNTOR 2019

Festivali i Fëmijëve “Lyra Fest”
—
Gjakovë, Pallati i Kulturës

NËNTOR 2019

Turneu “Xhafer Thaqi”
—
Gjakovë

NËNTOR 2019

Turneu “Bashkim Idrizi”
—
Gjakovë, Pallati i Kulturës

NËNTOR 2019

Ecje Bjeshkatore
në Bjeshkët e Pashtrikut
—
Gjakovë, Bjeshkët e Pashk-
trikut

15-18 NËNTOR 2019

Projekti i maturanteve
“Darka e Djergave”
—
Junik, Gjimnazi Kuvendi i
Junikut

> Festivali Lyra Fest është festival i këngës për fëmijë të moshës 5-13 vjec, që organizohet në qytetin e Gjakovës. Festivali ka për qëllim të krijoj një vend për fëmijë të talentuar në këndim, për kompozitor, orkestrues dhe tekstshkrues të skenës muzikore mbarëshqiptare.



27 DHJETOR-1 PRILL 2019 ●

Lëshime të Lira me Ski
dhe Snowboard “Freeride”

—
Junik, Gjeravicë, Bjeshkët e
Junikut



> Operatori Kroat “Lynx Freeride”, ka zgjedhur Bjeshkët e Junikut për të operuar si tour-operator në skijim të lirë që njihet ndryshe si Free-Ride dhe zhvillohet në dëborë të pashkelur. Ky aktivitet gjatë stinës së dimrit, sjellë në Junik dashamirë të këtij sporti nga e gjithë bota ku transporti në pikat e lëshimeve në Bjeshkë të Junikut bëhet përmes Ratrakëve të dëborës dhe Helikopterëve.

- Sporte
- ✚ Ecje në natyrë
- 🏠 Ngjarje Kulturore
- ✚ Ecje në Bjeshkë
- ⊕ Tjera
- 📖 Letërsi
- 📺 Arte Vizuele
- ✚ Arte Performuese
- 🌀 Rekreacion
- ✚ Ritual
- 📺 Panair
- 🍷 Gastronomi
- ✚ Koncert/Vallëzim, Edukim
- ✚ Vallëzim Tradicional, Aktrim, Koncert
- 📺 Artizanale





